



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 324, datë 30.12.2019

PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.285, DATË 16.12.2019 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR “MBI CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR
GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA,
TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË
PËRHERSHME”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4, 147/1/A të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 2 dhe 89 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, Vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 “Mbi miratimin e Vendimit për rregullat e një çështje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në kushtet e pazbatueshmërisë aktuale të neneve 45 dhe 46 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.285, datë 16.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, në paragrafin e I-rë, nëndarja “Gjykata e Apelit Korçë” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Ndryshimi i pikës 20 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“20. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, **Fatmira Hajdari**, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; e akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje”, “Ushtrim prostitucioni”.

2. Ndryshimi i pikës 27 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“27. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, **Vojsava Osmanaj (relatore)**, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Keqtrajtim i të miturve, etj.”.

3. Ndryshimi i pikës 28 të këtij vendimi në këtë mënyrë:

“28. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, **Vojsava Osmanaj**, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në

ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për tu mbrojtur, mbetur në tentativë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**